

**Titulli i punimit të diplomës master:
Shuarja e martesës, me theks të veçantë shkursorëzimi në Kosovë**

Kandidatja: Albulena Latifi

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi është analiza e procedurës së shuarjes së martesës (bazuar në legjislacionin që është në fuqi), me fokus shkursorëzimin në Kosovë. Siç e dijmë, martesë është një ndër institutet më të vjetra dhe më të rëndësishme shoqërore e juridike. Është bazë e krijimit të familjes. Martesë është e rregulluar me dispozita ligjore urdhëruese dhe shuarja e saj mund të bëhet vetëm sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhe mund të themi që e drejta për të lidhur martesë zakonisht shoqërohet edhe me të drejtën e shuarjes së saj.

Pra, martesë është një institucion shoqëror që gëzon mbrojtje nga shteti, që lidhet nën kushtet të cilat parashihen me ligj dhe shuarja e saj mund të bëhet vetëm në qoftë se organi kompetent-gjykata, bindet mbi pamundësinë e vazhdimit të saj. Sipas Ligjit për Familjen të Kosovës, martesë shuhet me vdekjen e bashkëshortit, shpalljen e bashkëshortit të zhdukur të vdekur, anulimit dhe shkursorëzimit.

Metodat e hulumtimit që janë përdorur gjatë këtij hulumtimi janë të ndryshme, si: Metoda krahasuese, metoda deduktive, metoda e analizës së legjislacioneve dhe metoda statistikore.

Fjalët kyçe: Martesë, shkursorëzimi, bashkëshortët.